

Kthim pergjigje Nr. 196 Mon 12/7/2020 12:17 PM
To: info@informim.al;

Pershendetje Z. Mehaj!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht ne Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 196, në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju bëjmë me dije se Administrata Tatimore administron informacion sipas Drejtorive Rajonale Tatimore dhe jo informacion në lidhje me subjektet sipas ndarjes administrative Bashki/Fshat. Konkretisht në DRT Elbasan ushtrojnë aktivitet 1157 subjekte të biznesit të madh.

Aktualisht subjekti "ROZAFa" me NIPT K48130547V, ka disa adresa deklarimi sekondare, njëra prej të cilave është Labinot - Fushë, por referuar mënyrës së administrimit të informacionit në Sistemit Informatik Tatimor nga organi tatimor, nuk është e mundur identifikimi i punonjësve të deklaruar nga adresat sekondare, pasi listëpagesa është në total për të gjithë të punësuarit e subjektit. Për këtë arsye është e pamundur të evidentojmë sa prej punëmarrësve të lartpërmendur janë të punësuar tek “Rozafa Labinot – Fushë”.

Faleminderit per mirekuptimin.

Pune te mbare
Hermelinda Hysenaj
Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
Tel Office : 04 2276 840
Web: www.tatime.gov.al